

**Kushtrim KUÇI**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

## **NDIKIMI I ANATOLISË PERËNDIMORE NË KRIJIMIN E KULTURËS SË STARÇEVËS, SHPJEGUAR ME SHEMBUJ TË VARIANTIT TË KOSOVËS**

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Kjo nismë për të hedhur dritë mbi një dukuri si ajo e ndikimit të Anatólisë perëndimore në krijimin e kulturës së Starçevës nuk është veçse një hap shumë i vogël rreth kësaj çështje, me të cilën nuk janë marrë aq sa duhet ekspertët nga perëndimi, as ata vendorë të territorit këtyre zonave kulturore e më pak ballkanasit tjerë, të cilët i prekë i njëjti fenomen, dhe aspak specialistët nga Kosova. Për ta shpjeguar këtë fenomen së pari do të flitet për lëvizjen e popullsisë dhe arsyet e saj nga Anatólia perëndimore, që bart në vete tri grupe kulturore si atë veriperëndimor rreth sitit Fikirtepe, pastaj atë perëndimor-qendror rreth Izmirit dhe grupin jugperëndimor, apo siç quhet ndryshe Qarku i Liqeneve ose kultura e Hacilar-it, deri në zonën e Starçevës, duke kaluar nëpër kulturat me të cilat kufizohet ose i ka më së afërti në Ballkan, e në bazë të kësaj do të bëhet krahasimi i gjetjeve arkeologjike si arkitektura, poçaria dhe veglat, në mes të Anatólisë perëndimore dhe versionit Kosovar të Starçevës, duke kaluar nëpër Grupin Ballkano-lindor dhe Grupin Egjean me kulturat e Thesalisë dhe të Maqedonisë.

**Fjalët çelës:** *Starçevë, Anatóli perëndimore, ndikim, Lëvizje e popullsisë, Ballkan*

## HYRJE

Starçeva shtrihet në Serbi, Kosovë, pjesën lindore të Vojvodinës, në një pjesë të Rumanisë afër Gjerdapit (Porta e hekurt), në verilindje të Kroacisë, në verilindje të Bosnjës e të Maqedonisë, si dhe në pjesën veriore të Malit të Zi<sup>1</sup>. Starçeva si nocion nuk mund të ketë kuptim në këtë shkrim pa shkruar për raportet, shkëmbimet e rrugëtimet e saja me kulturat me të cilat ajo kufizohet ose i ka të afërta në raport apo drejtim të lindjes dhe Anatólisë, si ajo e Ballkanit lindor dhe e Egjeut verior. Së pari do të flitet mbi këto raporte dhe sidomos mbi rrugëtimin e ndikimeve Azi e Vogël-Ballkan e deri te hapësira e Starçevës, andaj duhen shtjelluar këto dy koncepte arkeologjiko-kulturore në pika të shkurtra. Kjo më së miri bëhet me anë të poçarisë, duke filluar njëherë me tri grupet kulturore të Anatólisë oksidentale, që në fillim nuk kishin dallime të mëdha me njëra-tjetrën; të tria grupet kishin forma gjysmë-sferike apo sferike, më vonë kultura e Hacilar-it e zhvillon shumë teknikën e pikturimit, ndërsa dy të tjerat zhvillojnë më shumë teknikën *impreso* dhe atë me incizim, kështu që kulturat ballkanike, përfshirë këtu edhe atë të Starçevës, do të marrin elemente nga këto të tri grupe të sipërpërmendura. Në anën tjetër, meqë kultura e Starçevës nuk kufizohet me ndonjërin nga tri kulturat e Anatólisë perëndimore, ndikimet nuk bien në sy në shikim të parë, në të kundërtën e disa elementeve të grupit Ballkano-lindor apo të Greqisë Veriore dhe për nga forma e dekori është më e thjeshtë dhe e varfër e po ashtu në shikim të parë kjo kulturë, për këto arsye, duket si një rezultat i klimës dhe arealit kontinental. Shkolla e Greqisë Veriore është më e ndërlikuar dhe e pasur nga këto dy shkolla të tjera për sa i përket formave dhe dekorit, motivet i ka më shumë këndore e gjeometrike, për dallim nga ato dyja, që motivet i kanë më shumë lineare dhe natyrale, dhe grupi Ballkano-lindor i ka format më të gjata apo cilindrike e dominon më shumë se te dy kulturat tjera ngjyra e errët. Me një fjalë ndikimi i arritur, ndër të tjera me anë të lëvizjes së popullatës, e cila ka bartur me vete elemente të saj, si: bimët, kafshët, orenditë, mënyrën e vet të jetesës e të menduarit, ka sjellë në fakt bujqësinë, blegtorinë, poçarinë qeramike, format e para të

---

<sup>1</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja 2, ANUBH*, Sarajevë, 1979, f. 115-116.

arkitekturës, format e saja të skulpturës etj., elemente këto që do të jenë objekt studimi e krahasimi më poshtë, pas shtjellimit të itinerarit të zhvendosjes së popullsisë dhe arsyes së kësaj vetëzhvendosjeje; do të shtrohet pyetja se a ka pasur a jo ndikim të Azisë së Vogël në Ballkan, nëse po, si ka ardhur deri te kjo dukuri, përse erdhi deri te ky dinamizëm dhe cilat ishin pasojat e kësaj lëvizje më vonë në kohë?

### Lëvizja e popullsisë kah Ballkani

Si dëshmi që grupe njerëzore kanë emigruar nga Azia në Ballkan, që kanë krijuar por edhe zhvilluar neolitin e Ballkanit, kemi prezencën e kromozomit Y së bashku me haplogrupin J, me origjinë nga neoliti i Azisë Jugperëndimore në ADN-në e ballkanasit modern me rreth 2 deri 20%<sup>2</sup>. Lëvizja ka ndodhur në mënyrë sporadike dhe indirekte karshi hapësirës së Starçevës. Arsyet e kësaj lëvizjeje dhe të braktisjes së vendbanimit paraprak janë të ndryshme, si: rritja e popullatës, varfërimi i tokës, ndonjë katastrofë natyrale, etj. Duhet cekur se më 6100 cal BC ka pasur një ndryshim klimatik, ku të reshurat janë rralluar dhe temperatura është ngritur dhe, si pasojë, resurset janë rralluar. Ky mund të jetë një faktor i rëndësishëm për të ndryshuar vendbanimin<sup>3</sup> dhe një ndër rastet e zhvendosjes për në Evropë, por s'mund të jetë assesi as hera e parë apo e fundit. Kjo lëvizje kah Ballkani ka prurë me vete edhe drithërat e zbutura, si: grurin thekrën dhe elbin, mostra të të cilave janë gjetur në Barcin Höyük 5-6 dhe Bahçeliveler VIe-VIdı (6600-6400 kal. p.e.s.)<sup>4</sup> në pjesën veriperëndimore të Anatólisë<sup>5</sup>, pastaj kafshët e zbutura, si:

<sup>2</sup> Mihael Budja, Neolithic pots and potters in Europe: the end of demic diffusion migratory model, *Documenta Praehistorica* 40, University of Ljubljana press Journals, 2013, f. 39, 40, 46-47, fig. 5-6.

<sup>3</sup> Catherine Kuzucuoğlu, The Neolithic in Anatolia at the regional scale, Some issues concerning chronology and environmental contexts, *French Geoarchaeology in the 21st Century*, CNRS Editions, Paris, 2014, f.129-143.

<sup>4</sup> Cal BC: Kalibruar p.K, apo kalibruar para erës sonë. Ky term përdoret për të treguar datimin e kalibruar në vitet para Krishtit në kontekstin e arkeologjisë parahistorike.

<sup>5</sup> Hüreyli Balcı, Rana Özbal, Fokke Gerritsen, Erkan Fidan, Different manifestations of Neolithization in Northwest Anatolia? An Archaeobotanical Review from Barcin Höyük and Bahçelievler, Turkey, *Documenta Praehistorica* 49, University of Ljubljana press Journals, 2022, f. 5, 7, fig. 1b.

dhitë, delet, bovidët dhe derrin, eshtrat e të cilave janë gjetur tek Ulucak IV (6800-6500 kal. p.e.s.) rreth Izmirit dhe te Qarku i Liqeneve<sup>6</sup>, por edhe në grupin e Egjeut, si në Frachthi në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit VII (para 6500 kal. p.e.s.)<sup>7</sup>, atë të Ballkanit lindor, si në Kovaçevo Id (5700-5600 kal. p.e.s.) e Balgarchevo I (5600 kal. p.e.s.)<sup>8</sup> si dhe në hapësirën kulturore të Starçevës, por gjetjet e tilla në këtë të fundit nuk janë datuar<sup>9</sup>. Rrugëtimi i ndikimeve dhe i elementeve që sollën neolitit te Ballkani qendror bëhej në dy drejtime, çdo gjë që vinte nga Qarku i liqeneve kalonte nga Greqia veriore. Dhe çdo gjë që vinte nga Anatolia veriperëndimore kalonte nga grupi lindor i Ballkanit, me të cilin kufizohej Starçeva. Kurse Anatolia qendrore-perëndimore ka mundur ose duhej t'i shfrytëzonte këto dy udhë për lëvizje drejt Evropës. Si shembuj konkretë për këtë kemi poçarinë, dekori *impreso* e ai me incizim prejardhjen e kishin më shumë nga Anatolia veriperëndimore e qendrore, ndërsa ai me pikturim e kishte prejardhjen nga Qarku i Liqeneve. Por, përkundër kësaj, më parë është menduar nga disa parahistorianë se Evropa Juglindore dhe kulturat e saja neolitike janë autoktone dhe studimet, por edhe interesimet e përqendrimi në parahistorinë rreth Mesdheut,

---

<sup>6</sup> Levent Atici, Suzanne Pilaar Birch, Burçin Erdoğu, Spread of domestic animals across Neolithic western Anatolia: New zooarchaeological evidence from Uğurlu Höyük, the island of Gökçeada, Turkey, *PloS one* 12, no. 10, University at Buffalo - The State University of New York, 2017, f. 1-30.

<sup>7</sup> Susan Allen, Second Impressions: Expanding the Range of Cereals from Early Neolithic Franchthi Cave, Greece, *Ethnobiology Letters* 9, no. 2, University of Boston, 2018, f. 193.; Natalie Munro, Mary Stiner, Zooarchaeological evidence for early Neolithic colonization at Franchthi cave, (Peloponnese, Greece), *Current Anthropology* 56, No. 4, the University of Chicago press, 2015, f. 598. ; Catherine Perlès, Anita Quiles, Hélène Valladas, Early seventh-millennium AMS dates from domestic seeds in the Initial Neolithic at Franchthi Cave (Argolid, Greece), *Antiquity* 87, no. 338, Cambridge University Press, 2013, f. 1001-1015.

<sup>7</sup> Elisha Owara van den Bos, *Living Neolithization: a multi-scalar approach to houses, settlements and habitation practices in Western Anatolia and Southeastern Europe (c. 7000-5000 BCE)*, Tezë doktorature e mbrojtur në Univerzitet të Vrije-s Amsterdam, 2021, f. 255-256, 265, Tab. 9.1.

<sup>8</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja* 2, ANUBH, Sarajevë, 1979, f. 138-139.

ishin te Lindja e Mesme dhe Evropa Juglindore, kurse Anatolia oksidentale, për shkak se nuk ka pasur gati hiq zbulime apo site neolitike, nuk ishte në mendjen e shkencëtarëve<sup>10</sup>. Ekspertët e fushës nga Evropa Juglindore, të ndikuar nga politika e nacionalizmi, kanë besuar se neolitizimi *in situ* ishte si shkak i zhvillimit të brendshëm e jo si pasojë e difuzionizmit<sup>11</sup>. Në lidhje me këtë janë marrë parasysh vendbanimet, poçaria, bujqësia me blegtorinë etj., për të cilat do të flitet më poshtë, kur merret parasysh Evropa juglindore dhe Anatolia perëndimore në përgjithësi, përfshirë këtu edhe Starçevën. Për këtë të fundit ekspertët e fushës në Serbi, më parë, mendonin se kultura e Starçevës ishte një evoluim i kulturës paraprake mezolitike të Lepenski Virit, por duke marrë parasysh se aty janë gjetur gjetje edhe të periudhës së Starçevës, kemi të bëjmë me një kontaminim të vlerave, qoftë të njëjës apo të tjetrës kulturë.

### Vendbanimet dhe arkitektura

Sa u përket vendbanimeve të kulturës së Starçevës në Kosovë, duke pasur një reliev kryesisht të rrafshët edhe strukturat e jetesës janë ngritur në terren të rrafshët, e shtrirë horizontalisht dhe vetëm siti i Runikut në tërë këtë kulturë i takon tipit *Tell*. Në fazat e para (Starçevë I) banesat janë nëntokësore, me formë rrethore a ovale, të mbuluara me material bimor. Raste të tilla si duket nuk ka në Kosovë, por në Serbi kemi lokalitetin eponim të Starçevës dhe në fazat më të hershme të Vinçës. Në fazat e mëvonshme (Starçevë IIa) banesat që dalin në sipërfaqe kanë formë drejtkëndore, struktura është përbërë nga degë druri të mbuluar dhe ngjitur me baltë, si në Glladnicë e Runik, ku dysHEMEJA e shtypur gjendet te kjo e fundit, ndërsa e para

---

<sup>10</sup> Mehmet Özdoğan, Neolithic Sites in the Marmara Region: Fikirtepe, Pendik, Yarımburgaz, Toptepe, Hoca Çesme, and Asagi Pinar, *The Neolithic in Turkey; 5: Northwestern Turkey and Istanbul*, 2013, f. 167, 173-174.

<sup>11</sup> Mehmet Özdoğan, Archaeological evidence on the westward expansion of farming communities from eastern Anatolia to the Aegean and the Balkans, *Current anthropology* 52, no. 4, the University of Chicago press, 2011, f. 415. ; Jean-Paul Demoule, Collectif. De Méditerranée et d'ailleurs... Mélanges offerts à Jean Guilaine. La colonisation néolithique de l'Europe balkanique : chronologie et processus, *Archives d'Écologie Préhistorique*, Collège de France, Tuluz, Francë 2009, f. 251-263.

s'ka dysHEME, por themelet i ka të mbushura me gurë.<sup>12</sup> Kjo tregon se në Kosovë, apo te këto dy vende, kishim një jetë stabile, ekonomikisht të përparuar e si duket pa rreziqe të mëdha të jashtme në krahasim me rajonet e tjera të kësaj kulture. Shembuj të tillë arkitekturorë i gjejmë së pari në Anatinë perëndimore, në pjesën veriperëndimore në Aktopraklik C (6400-6000 kal. p.e.s.), ku kemi strukturë rrethore të nëndheshme<sup>13</sup>, njëjtë në Maqedoninë e Greqisë si në Stavropouli Ia (5890 kal. p.e.s.)<sup>14</sup> dhe në grupin ballkano-lindor në Kranitsi (6200-5900 kal. p.e.s.)<sup>15</sup>. Për shtëpitë sipërfaqësore kënddrejta, të ngritura me baltë e drunj, kemi shembuj të ngjashëm në rrethin e Izmirit në Ulucak Va-f (6200-6000 kal. p.e.s.)<sup>16</sup>, në Nea Nikomedeia I-II të Maqedonisë së Greqisë (6400-6200 kal. p.e.s.)<sup>17</sup> dhe në Kovachevo Ia, të grupit ballkano-lindor (6100 kal. p.e.s.)<sup>18</sup>. Sa u përket banesave të nëndheshme duhet marrë parasysh se ato ishin e vetmja strukturë që ia mundësonte qëndrimin aty popullatës në një klimë të re, por me

<sup>11</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja 2*, ANUBH, Sarajevë, 1979, f. 115-116, 120-122, 138. ; Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 49, 51.; Blazenka Stalio, Naselje i stan neolitskog perioda, *Neolit Centralnog Balkana*, Narodni Muzej, Beograd, 1968, f.83.

<sup>12</sup> Georgia Adamidou, *Neolithic settlements and houses in north-western Turkey and northern Greece*, Master Thesis, Master of Arts in Black Sea and Eastern Mediterranean Studies, e mbrojtur në International Hellenic University, Selanik, 2018, f.11, 28-29, 90, fig. 16.

<sup>13</sup> Po aty, f. 58, 115, 128, fig. 65, Tab. 10.

<sup>14</sup> Elisha Owara van den Bos, *Living Neolithization: a multi-scalar approach to houses, settlements and habitation practices in Western Anatolia and Southeastern Europe (c. 7000-5000 BCE)*, Tezë doktrature e mbrojtur në Univerzitet të Vrije-s Amsterdam, 2021, f. 266, 293, Tab. 10.4.

<sup>15</sup> Po aty, f. 122-124. fig. 6.6.

<sup>16</sup> Georgia Adamidou, *Neolithic settlements and houses in north-western Turkey and northern Greece*, Master Thesis, Master of Arts in Black Sea and Eastern Mediterranean Studies, e mbrojtur në International Hellenic University, Selanik, 2018, f. 62-63, 119, 128, fig. 74, Tab. 10.

<sup>17</sup> Elisha Owara van den Bos, *Living Neolithization: a multi-scalar approach to houses, settlements and habitation practices in Western Anatolia and Southeastern Europe (c. 7000-5000 BCE)*, Tezë doktrature e mbrojtur në Univerzitet të Vrije-s Amsterdam, 2021, f. 273, 449, Tab. 3.

kalimin e kohës ajo u adaptua ndaj rrethanave dhe, si pasojë, strukturat banesore u ndërtuan mbi dhe. Tipat tjerë të ndërtimit, si ai i *pisé*-së, apo me tulla të papjekura, për shkak të klimës lokale dhe të përbërjes së dheut, nuk kanë mundur të përdreshin te ne. Dhe, mos të harrohet se disa ekspertë mendonin se kultura e Starçevës, por edhe arkitektura e saj në veçanti, rridhte nga ajo e Lepenski Virit, por siç dihet, në fazën e fundit të kësaj kulture, Lepenski Vir II, ndërtesat ishin trapezoidale dhe sipërfaqësore, ndërsa ato të Lepenski Vir IIIa, apo të Starçevës, ishin rrethore dhe nëntokësore.<sup>19</sup> Këtu mund të themi lirisht se kemi të bëjmë me dy grupe njerëzore (popuj) e kultura të ndryshme nga njëra-tjetra.

## Poçaria

Poçaria e Starçevës ndahet në tri faza: Faza I, Faza II, që ndahet në dy nënfaza Faza IIa, Faza IIb, si dhe Faza III. Në fazën I (6200-5900 kal. p.e.s.)<sup>20</sup> kemi enë monokrome, monokrome të kuqe me lustrim e lëmim, barbotine dhe *impreso*, të aplikuara me thonj a mjet, e me incizim të çrregullt, por edhe me romboide e hashure. Format janë sferike ose gjysmë-sferike, ndërsa fundi është i sheshtë ose unazor<sup>21</sup>. Në fazën IIa (5900-5650 kal. p.e.s.)<sup>22</sup> del në Kosovë pikturimi i bardhë (i papublikuar) në sfond të errtë dhe ai i errët apo i kuq në sfond të çelur. Për herë të parë del kupa, që ka këmbë të shkurtër. Nga vegjet kemi sosh me pullë, horizontale, plastike, tunelore të shpuara

<sup>19</sup> Blazenka Stalio, Naselje i stan neolitskog perioda, *Neolit Centralnog Balkana, Narodni Muzej*, Beograd, 1968, f. 83.; Dragoslav Srejovic, Protoneolit-Kultura Lepenskog Vira, *Praistorija jugoslovenskih zemalja, ANUBH*, Sarajevë, 1979, f. 76.

<sup>20</sup> Marko Porčić, Tamara Blagojević, Sofija Stefanović, Demography of the Early Neolithic Population in Central Balkans: Population Dynamics Reconstruction Using Summed Radiocarbon Probability Distributions, *PLoS ONE* 11, No. 8, Universiteti i Firencës, 2016. f. 5.

<sup>21</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja* 2, *ANUBH*, Sarajevë, 1979, f. 124-128, 132-134, 136; Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, *SANU*, Beograd, 1998, f. 49, 51, 53.

<sup>22</sup> Marko Porčić, Tamara Blagojević, Sofija Stefanović, Demography of the Early Neolithic Population in Central Balkans: Population Dynamics Reconstruction Using Summed Radiocarbon Probability Distributions, *PLoS ONE* 11, no. 8, Universiteti i Firencës. Firencë 2016. f. 5.

horizontalisht. Nga motivet kemi, vija zigzage, të kthyera, të drejta paralele vertikale, të ndërprera, valore, hapësira të mbushura me rrjete etj..<sup>23</sup> Në fazën IIb (5650-5500 kal. p.e.s.)<sup>24</sup> del këmba konike<sup>25</sup>. Në fazën III (5500-5400 kal. p.e.s.)<sup>26</sup> shfaqen spiralja që përfundon në kthetër dhe forma bikonike.<sup>27</sup> Forma të ngjashme shihen edhe tek enët e grupit veriperëndimor të Anatólisë (6400-6000 kal. p.e.s.)<sup>28</sup>. Tek Anatólia perëndimore shihet gryka e enëve me mure të drejta apo në shkallë më të pjerrëta, më vonë ka hapje konvekse. Këso shembuj mund t'i shohim në Adatepe të Anatólisë veriperëndimore (6000-5700 kal. p.e.s.)<sup>29</sup>. Vegje të ngjashme si të variantit tonë të Starçevës

<sup>23</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja* 2, ANUBH, Sarajevë, 1979, f. 124-128, 132-134, 136; Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 49, 51. ; Borislav Jovanović, *Istorijat keramičke industrije, Neolit Centralnog Balkana*, Narodni muzej, Beograd, 1968, f. 123-124, 129.

<sup>24</sup> Marko Porčić, Tamara Blagojević, Sofija Stefanović, Demography of the Early Neolithic Population in Central Balkans: Population Dynamics Reconstruction Using Summed Radiocarbon Probability Distributions, *PLoS ONE* 11, no. 8, Universiteti i Firencës, 2016. f. 5.

<sup>25</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja* 2, Sarajevë, 1979, f. 134-135. ; Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 51; Borislav Jovanović, *Istorijat keramičke industrije, Neolit Centralnog Balkana*, Narodni muzej, Beograd, 1968, f. 129.

<sup>26</sup> Marko Porčić, Tamara Blagojević, Sofija Stefanović, Demography of the Early Neolithic Population in Central Balkans: Population Dynamics Reconstruction Using Summed Radiocarbon Probability Distributions, *PLoS ONE* 11, no. 8, Universiteti i Firencës, 2016. f. 1, 5.

<sup>27</sup> Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja* 2, Sarajevë, 1979, f. 134-135; Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 51.; Borislav Jovanović, *Istorijat keramičke industrije, Neolit Centralnog Balkana*, Narodni muzej, Beograd, 1968, f. 129.

<sup>28</sup> Jürgen Seeher, Evidence of Seventh/Early Sixth Millenium BC Neolithic Sites in North-Western Anatólia: Beginnings - New Research in the Appearance of the Neolithic between Northwest Anatólia and the Carpathian Basin, *Verlag Marie Leidorf* 1, Rahden/Westf, 2011, f. 49, fig. 2.

<sup>29</sup> Harun Oy, New Survey and typological study of prehistoric Dutluca region, Usak, Turkey, *Mediterranean Archaeology and Archeometry* 21, no. 2, Keifin, Kinë, 2021, f. 81-83, fig. 17.

kemi në Keçiçayri (6600-6300 kal. p.e.s.)<sup>30</sup>. Fund të ngjashëm, sidomos unazor apo këmbë konike e cilindrike, kemi në Araptepe të Anatosisë qendrore-perëndimore (6000-5700 kal. p.e.s.)<sup>31</sup>, ndërsa funde të sheshta kemi në tërë lokalitetet parahistorike të Anatosisë perëndimore. Ngjashmëri ka edhe për nga teknika e prodhimit dhe dekorit, si: monokromja, monokromja e kuqe, barbotini, me Keçiçayrin<sup>32</sup>, për nga teknika *impreso* dhe me incizim me Anatinë veriperëndimore dhe qendrore e perëndimore<sup>33</sup>. Te monokromja e kuqe, kemi teknikën *slipped* apo *red slip*, që arrihet me anë të mbulimit të enës pas pjekjes, krejtësisht a pjesërisht, me një shtresë argjilore të përzier me okër, gjë që mund t'i themi edhe barbotin shumë i rregullt, dhe në fund mund të lëmohet e të lustrohet. Sa i përket poçarisë së pikturuar, (6200-5900 kal. p.e.s.) më së shumti është e pranishme në Qarkun e Liqeneve. Ajo aplikohet edhe me ngjyrë të mbylltë si e kuqe, e hirtë apo e zezë në sfond të çeltë si atë të verdhë, të kuqe etj., format i ka konike, nga motivet kemi, trekëndësha vija këndore, simbole njerëzore, kafshësh etj.<sup>34</sup> E njëjta gjë pak a shumë përsëritet edhe te grupi Lindor Ballkanik dhe ai Egjean. Së pari kemi enë monokrome, ku hyjnë, si te rastet e sipërcekura, edhe qeramika e trashë, pastaj ajo monokrome e kuqe dhe barbotini (6,210–6,050 kal. p.e.s.) e më pas del ajo e pikturuar si

<sup>30</sup> Sari, Deniz, Şemsettin Akyol, The Early Neolithic pottery of Keçiçayiri and its place in the North-western Anatolian Neolithisation proces, *Documenta Praehistorica*, 46, University of Ljubljana press Journals, 2019, 145-147, 149, 156, fig. 12, 15. PL. 4. 47.

<sup>31</sup> Clemens Lichter, How did farming reach Europe, Anatolian-European relations from the second half of the 7th through the first half of the 6th millenium cal BC: Western Anatolia in the Late Neolithic and Early Chalcolithic: the actual state of research, *BYZAS* 2, Istanbul, 2005, f. 65-66, fig. 2.

<sup>32</sup> Sari, Deniz, Şemsettin Akyol, The Early Neolithic pottery of Keçiçayiri and its place in the North-western Anatolian Neolithisation proces, *Documenta Praehistorica*, 46, University of Ljubljana press Journals, 2019, 145, fig. 12.

<sup>33</sup> Jürgen Seeher, Evidence of Seventh/Early Sixth Millenium BC Neolithic Sites in North-Western Anatolia: Beginnings - New Research in the Appearance of the Neolithic between Northwest Anatolia and the Carpathian Basin, *Verlag Marie Leidorf* 1, Rahden/Westf, 2011, f. 49. fig. 2.

<sup>34</sup> Eylem Özdoğan, Current research and new evidence for the Neolithization process in Western Turkey, *European Journal of Archaeology* 18, no. 1, Cambridge University Press, 2015, f. 44-45, fig. 5.

në Kovaçevo Ia-d, e sidomos me motive të errëta, të ngjashme me ato Anatolike e të Egjeut, por më të thjeshta e të varfra. Format janë po ashtu të rrumbullakuara, ndërsa më vonë shfaqet konveksiteti, si buzët konvekse. Këtë e shoqëron edhe këmba cilindrike dhe konike, gryka cilindrike e konike, vegjët kanë po ashtu forma gungaçe e tunelore dhe shpimi pos horizontal është edhe vertikal (5,700–5,500 kal. p.e.s.)<sup>35</sup>. Këta shembuj përsëriten te Greqia, sidomos te Nea Nikomodea, Sesklo<sup>36</sup> etj., datimet shkojnë nga 6450-6200 kal. p.e.s., për poçarinë para pikturimit si për atë monokrome, monokrome të kuqe, barbotine, dhe impreso apo me incizim dhe 6200-5900 për fillimin e teknikës së pikturimit.<sup>37</sup> Para përfundimit duhet cekur se për poçarinë në përgjithësi dhe teknikat e saj, sidomos për barbotinin, ka pasur autorë që e kanë konsideruar si krijim vetanak i Starçevës e jo si ndikim nga lindja.<sup>38</sup>

<sup>35</sup> Ljubo Fidanoski, Early Neolithic in North Macedonia and Bulgaria: Geographical and Cultural Relations, *Studia Universitatis Hereditati*, 9, no. 1, University Primorske Press, Primorske. Slloveni. 2021, f. 19, 23-24.

fig. 4; Raiko Krauss, On the “Monochrome” Neolithic in Southeast Europe: Beginnings – New Research in the Appearance of the Neolithic between Northwest Anatolia and the Carpathian Basin, *Elektronische Publikationen des Deutschen Archäologischen Instituts 1*. Rahden. 2011, f. 109-122; Tanya Dzhafezova, Organic temper and the Early Neolithic pottery production: interpretational challenges, *Acta Archaeologica 91*, no. 2, Kopenhagë, 2020, f. 72, fig. 7 C-3.

<sup>36</sup> M. H. J. M. N. Wijnen, Chapter III: Analysis of the early Neolithic I pottery from Sesklo, *Analecta Praehistorica Leidensia XIV: The early Neolithic I settlement at Sesklo: An early farming community in Thessaly, Greece 14*, Univerziteti i Leidens, 1981, f. 28.

<sup>37</sup> Paraskevi Yiouni, *The pottery from Nea Nikomedeia in its Balkan context*, University College London, 1992, f. 72-75, 92-95, 101-111, 146-152, 154, 156, 39, 57, 59, 61, 115, 116, 118.; Georgia Karamitrou-Mentessidi, Nikos Efstratiou, Malgorzata Kaczanowska, Januzs Krzysztof Kozłowski, Early Neolithic Settlement of Mavropigi in Western Greek Macedonia, *Eurasian Prehistory 12*, no.1-2, Univerziteti i Harvardit, 2017, f. 58, 60. ; Maxime Brami, Volker Heyd, The origins of Europe's first farmers: The role of Hacilar and western Anatolia, fifty years on, *Praehistorische Zeitschrift 86*, no. 2, Berlin, 2011, f. 172-173, 175.

<sup>38</sup> Borislav Jovanović, Istorijat keramičke industrije, *Neolit Centralnog Balkana*, Narodni muzej, Beograd, 1968, f. 122-123; Dragoslav Srejavic, Neolitska Plastika Centralnobalkanskog Područja: *Neolit Centralnog Balkana*, Narodni Muzej, Beograd, 1968, f. 225; Shënimi 19.

## Skulptura

Nga qeramika, fillimet e saj datojnë nga faza IIa, që i ka tri etapa: në të parën format janë pak a shumë cilindrike, sytë e vetullat së bashku me flokët janë të incizuara, hunda është e shtuar si shtojcë plastike; etapa e dytë që i përket fazës IIb, e ka hundën e modeluar, pjesët tjera, sytë e vetullat i ka të incizuara, pra kemi të bëjmë me një koncept më të thjeshtë e më abstrakt, dhe; faza III fytyrën e ka pa detaje, por gjymtyrët dalin. Pasi që nuk është gjetur ndonjë skulpturë e Starçevës në fazën I, pse disa autorë mendojnë se edhe ky art është krijuar nga banorët e kësaj kulture? Në fazën e parë nuk është gjetur ndonjë skulpturë arsyetohet se në fillimet e saj këto statueta janë bërë nga druri, por studimi më poshtë e dëshmon të kundërtën<sup>39</sup>. Në Ekşi Höyük, te Qarku i Liqeneve, i kemi tri figura nga argjila e pjekur që datojnë 6400/6300-6000 kal. p.e.s., e që për nga incizimi e punimi i syve dhe forma e skulpturave përngjajnë me ato të Starçevës.<sup>40</sup> Ngjashmëri ka edhe në Kovachevo Ia 6120- 5900 kal. p.e.s.<sup>41</sup> e në Mavropigi të Maqedonisë greke 6200-5900 kal. p.e.s.<sup>42</sup>, por këtu kemi një ndikim të jo drejtpërdrejtë nga Anatolia perëndimore nëpërmjet këtyre kulturave intermediare.

<sup>38</sup> Dragoslav Srejovic, *Neolitska Plastika Centralnobalkanskog Podrucja: Neolit Centralnog Balkana*, Narodni Muzej, Beograd. 1968, f. 180-184, Tab. I-12; Milutin Garašanin, *Centralnobalkanska zona, Praistorija jugoslavenskih zemalja 2*, Sarajevë, 1979, f. 130-131; Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 425, 443, fig. 2, 36.

<sup>40</sup> Fulya Dedeoğlu, Ali Ozan, Erim Konakçı, Bora Temür, Başak Boz, Bogdana Milić, Gülçin İlgezdi-Bertram, Mücella Erdalkıran, *Archaeological and Analytical Investigation of a New Neolithic Site In Western Anatolia: Ekşi Höyük (Denizli, Turkey)*, *Mediterranean Archaeology and Archaeometry* 23, no. 1, 2023, f. 4, 12, fig. 4, 12.

<sup>41</sup> Małgorzata Grębska-Kulow, Petar Zidarov, *The routes of Neolithisation: the middle struma valley from a regional perspective*, *Open Archaeology* 7, no.1, De Gruyter, 2021, f. 1002, 1004-1005, fig. 3 (1). Tab. 1.

<sup>42</sup> Georgia Karamitrou-Mentessidi, Nikos Efstratiou, Małgorzata Kaczanowska, Januzs Krzysztof Kozłowski, *Early Neolithic Settlement of Mavropigi in Western Greek Macedonia*, *Eurasian Prehistory* 12, No.1-2, Universiteti i Harvardit, 2017, f. 62, 66, 68, fig. 43.

## Veglat

Sa u përket veglave nga stralli apo guri i palëmuar duhet cekur se në Ballkan kemi tipin e veglave *Balkan flint*, të një cilësie të lartë, për të cilin mendojmë se është shpikur nga grupi ballkano lindor dhe ky tip mjeti nuk e ka lënë futjen në Evropë të veglave të tilla nga Azia. Nga veglat kemi gurin e lëmuar apo sëpatat si në Runik<sup>43</sup>, në Anatoli i kemi te Çukuriçi Höyük IX 6200-6300 kal. p.e.s. te Qarku i Liqeneve<sup>44</sup> dhe në Maqedoni të Greqisë 6200-5900 kal. p.e.s.<sup>45</sup> Nga ashti, si risi, është luga e gjetur në Runik<sup>46</sup>, rast të ngjashëm kemi në Fikirtepe në Anatinë veriperëndimore 6400-6000 kal. p.e.s.<sup>47</sup> dhe në grupin Lindor Ballkanik në Hoca Çeshme IV-III 6400-6000 kal. p.e.s..<sup>48</sup>. Luga nga ashti (femur i *bos primigenus*), që përdorej për ushqim të modifikuar, është tregues e mënyrës së jetës sedentare dhe të ekonomisë të bazuar në bujqësi dhe blegtori.

---

<sup>43</sup> Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 436, fig. 24.*

<sup>44</sup> Barbara Horejs, Bogdana Milic, Christoph Schwall, Maria Röcklinger, Christopher Britsch, Lisa Betina, Çukuriçi Höyük 1: Anatolia and the Aegean from the 7th to the 3rd Millenium BC, *OREA 5, Austrian Academy of Science, Vjenë, 2017, f. 16, fig. 8 (1).* ; Christoph Schwall, Michael Brandl, Tatjana M. Gluhak, Bogdana Milić, Lisa Betina, Lasse Sørensen, Danilo Wolf, Maria M. Martinez, Barbara Horejs, From near and far: Stone procurement and exchange at Çukuriçi Höyük in Western Anatolia, *Journal of Lithic Studies 7, no. 3, 2020, f. 1-25, Universiteti i Edinburgut, 2020, f. 1-20.*

<sup>45</sup> Georgia Karamitrou-Mentessidi, Nikos Efstratiou, Malgorzata Kaczanowska, Januzs Krzystof Kozlowski, Early Neolithic Settlement of Mavropigi in Western Greek Macedonia, *Eurasian Prehistory 12, no.1-2, Universiteti i Harvardit, 2017, f. 62, 68, fig. 35.*

<sup>46</sup>Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue, 90, SANU, Beograd, 1998, f. 435, fig. 23.*

<sup>47</sup> Mehmet Özdoğan, Neolithic Sites in the Marmara Region: Fikirtepe, Pendik, Yarımburgaz, Toptepe, Hoca Çesme, and Asagi Pinar, *The Neolithic in Turkey; 5: Northwestern Turkey and Istanbul, 2013, f. 179-183, 212, fig. 14.*

<sup>48</sup> Po aty, f. 182, 241, fig. 87.

## PËRFUNDIMI

Siç e kemi vërejtur ndikimi i Anatólisë perëndimore në krijimin dhe neolitizimin jo vetëm të Ballkanit qendror, e më saktësisht të kulturës së Starçevës, por edhe të Ballkanit dhe Evropës në përgjithësi, nuk mund të mohohet më e as të vihet në pyetje si dikur. Dëshmitë tregojnë se Anatólia perëndimore, nëpërmjet lëvizjes së popullatës dhe kontakteve të vendosura, bëri që ky ndikim të prekë çdo aspekt të jetës së njeriut në Evropë, si në ekonomi duke sjellë ngulimin, bujqësinë dhe blegtorinë, pastaj arkitekturën, poçarinë nga qeramika me teknikat e saja si ajo me pikturim, incizim, barbotin, etj., veglat e gurit të lëmuar dhe ato të ashtit etj. Kjo dinamikë, ky ndikim dhe kjo lëvizje e popullatës nuk do të përfundojnë me Neolitit e hershëm, por do të vazhdojnë edhe gjatë Neolitit të vonë dhe me tërë këto elemente do të krijohet kultura e Vinçës, dinamizëm ky që do të vazhdojë deri në ditët tona.

## BIBLIOGRAFIA

Barbara Horejs, Bogdana Milic, Christoph Schwall, Maria Röcklinger, Christopher Britsch, Lisa Betina, Çukuriçi Höyük 1: Anatólia and the Aegean from the 7th to the 3rd Millenium BC, *OREA 5*, Austrian Academy of Science, Vjenë, 2017, f. 16.

Blazenka Stalio, Naselje i stan neolitskog perioda, *Neolit Centralnog Balkana, Narodni Muzej*, Beograd, 1968, f. 77-106.

Borislav Jovanović, Istorijat keramičke industrije. *Neolit Centralnog Balkana, Narodni muzej*, Beograd, 1968, f. 107-176.

Catherine Kuzucuoğlu, The Neolithic in Anatólia at the regional scale. Some issues concerning chronology and environmental contexts, *French Geoarchaeology in the 21st Century*, CNRS Editions, Paris, 2014, f. 129-143.

Catherine Perlès, Anita Quiles, Hélène Valladas, Early seventh-millennium AMS dates from domestic seeds in the Initial Neolithic at Franchthi Cave (Argolid, Greece), *Antiquity* 87, no. 338, Cambridge University Press, 2013, f. 1001-1015.

Clemens Lichter, How did farming reach Europe, Anatólian-European relations from the second half of the 7th through the first

half of the 6th millenium cal BC,: Western Anatolia in the Late Neolithic and Early Chalcolithic: the actual state of research, *BYZAS* 2, Istanbul, 2005, f. 1-329.

Christoph Schwall, Michael Brandl, Tatjana M. Gluhak, Bogdana Milić, Lisa Betina, Lasse Sørensen, Danilo Wolf, Maria M. Martinez, Barbara Horejs. From near and far: Stone procurement and exchange at Çukuriçi Höyük in Western Anatolia, *Journal of Lithic Studies* 7, no. 3, 2020, f. 1-25, Universiteti i Edinburgut, Edinburg, 2020, f. 1-20.

Dragoslav Srejavic, Neolitska Plastika Centralnobalkanskog Podrucja: *Neolit Centralnog Balkana*, Narodni Muzej Beograd. 1968.

Dragoslav Srejavic, Protoneolit-Kultura Lepenskog Vira, *Praistorija jugoslovenskih zemalja*, ANUBH, Sarajevë, 1979, f. 33-79.

Elisha Owara van den Bos, *Living Neolithization: a multi-scalar approach to houses, settlements and habitation practices in Western Anatolia and Southeastern Europe (c. 7000-5000 BCE)*, Tezë doktorature e mbrojtur në Univerzitet të Vrije-s Amsterdam, 2021, f. 1-481.

Eylem Özdoğan, Current research and new evidence for the Neolithization process in Western Turkey, *European Journal of Archaeology* 18, no. 1, Cambridge University Press, 2015, f. 33-59.

Fulya Dedeoğlu, Ali Ozan, Erim Konakçı, Bora Temür, Başak Boz, Bogdana Milić, Gülçin İlgezdi-Bertram, Mücella Erdalkıran, Archaeological and Analytical Investigation of a New Neolithic Site In Western Anatolia: Ekşi Höyük (Denizli, Turkey), *Mediterranean Archaeology and Archaeometry* 23, no. 1, 2023, f. 1-29.

Georgia Adamidou, *Neolithic settlements and houses in north-western Turkey and northern Greece*, Master Thesis, Master of Arts in Black Sea and Eastern Mediterranean Studies, e mbrojtur në International Hellenic University, Selanik, 2018.

Georgia Karamitrou-Mentessidi, Nikos Efstratiou, Malgorzata Kaczanowska, Januzs Krzysztof Kozłowski, Early Neolithic Settlement of Mavropigi in Western Greek Macedonia, *Eurasian Prehistory* 12, No.1-2, Universiteti i Harvardit, 2017, f. 47-116.

Harun Oy, New Survey and typological study of prehistoric Dutluca region, Usak, Turkey, *Mediterranean Archaeology and Archeometry* 21, No. 2, Keifin, Kinë, 2021, f. 69-92.

Hüreyla Balcı, Rana Özbal, Fokke Gerritsen, Erkan Fidan Different manifestations of Neolithization in Northwest Anatolia? An Archaeobotanical Review from Barcın Höyük and Bahçelievler, Turkey, *Documenta Praehistorica* 49, University of Ljubljana press Journals, 2022, f. 28-44.

Jean-Paul Demoule, Collectif, De Méditerranée et d'ailleurs... Mélanges offerts à Jean Guilaine. La colonisation néolithique de l'Europe balkanique: chronologie et processus, *Archives d'Écologie Préhistorique*, Collège de France, Tuluz, Francë 2009, f. 251-268.

Jürgen Seeher, Evidence of Seventh/Early Sixth Millenium BC Neolithic Sites in North-Western Anatolia: Beginnings - New Research in the Appearance of the Neolithic between Northwest Anatolia and the Carpathian Basin, *Verlag Marie Leidorf* 1, Rahden/Westf, 2011, f. 47-55.

Levent Atici, Suzanne Pilaar Birch, Burçin Erdoğan, Spread of domestic animals across Neolithic western Anatolia: New zooarchaeological evidence from Uğurlu Höyük, the island of Gökçeada, Turkey, *PLoS one* 12, no. 10, University at Buffalo - The State University of New York, 2017, f.1-30.

Ljubo Fidanoski, Early Neolithic in North Macedonia and Bulgaria: Geographical and Cultural Relations, *Studia Universitatis Hereditati*, 9, No. 1, University Primorske Press, Primorske. Slloveni. 2021, f. 19, 23-24.

Małgorzata Grębska-Kulow, Petar Zidarov. The routes of Neolithisation: the middle struma valley from a regional perspective, *Open Archaeology* 7, No.1, De Gruyter, 2021, f. 1000-1014.

Maria Gurova, Balkan Flint - fiction and/or trajectory to Neolithization: Evidence from Bulgaria, *Bulgarian e-Journal of Archaeology* 1, Sofje f. 15-49.

Marko Porčić, Tamara Blagojević, Sofija Stefanović, Demography of the Early Neolithic Population in Central Balkans: Population Dynamics Reconstruction Using Summed Radiocarbon Probability Distributions, *PLoS ONE* 11, No. 8, Universiteti i Firencës, 2016, f. 1-12.

Maxime Brami, Volker Heyd, The origins of Europe's first farmers: The role of Hacilar and western Anatolia, fifty years on, *Praehistorische Zeitschrift* 86, no. 2, Berlin, 2011, f. 165-206.

Mehmet Özdoğan, Archaeological evidence on the westward expansion of farming communities from eastern Anatolia to the Aegean and the Balkans, *Current anthropology* 52, no. 4, the University of Chicago press, 2011, f. 415-430.

Mehmet Özdoğan, Neolithic Sites in the Marmara Region: Fikirtepe, Pendik, Yarımburgaz, Toptepe, Hoca Çesme, and Asagi Pinar, *The Neolithic in Turkey; 5: Northwestern Turkey and Istanbul*, 2013, 167-269.

M. H. J. M. N. Wijnen, Chapter III: Analysis of the early Neolithic I pottery from Sesklo, *Analecta Praehistorica Leidensia XIV: The early Neolithic I settlement at Sesklo: An early farming community in Thessaly, Greece 14*, Univerziteti i Leidens, 1981, f. 21-38.

Mihael Budja, Neolithic pots and potters in Europe: the end of demic diffusion migratory model, *Documenta Praehistorica* 40, University of Ljubljana press Journals, Ljubljana, 2013, f. 38-56.

Milutin Garašanin, Centralnobalkanska zona, *Praistorija jugoslavenskih zemalja* 2, ANUBH, Sarajevë, 1979, f. 79-212.

Natalie Munro, Mary Stiner, Zooarchaeological evidence for early Neolithic colonization at Franchthi cave, (Peloponnese, Greece), *Current Anthropology* 56, No. 4, the University of Chicago press, 2015, f. 596-603.

Nenad Tasic, *The Archaeological Treasures of Kosovo and Metohija From the Neolithic to the Early Middle Ages, The Starcevo Culture Catalogue*, 90, SANU, Beograd, 1998.

Paraskevi Yiouni, *The pottery from Nea Nikomedeia in its Balkan context. University of London, University College London*, 1992, f. 1-340.

Raiko Krauss, On the "Monochrome" Neolithic in Southeast Europe: Beginnings – New Research in the Appearance of the Neolithic between Northwest Anatolia and the Carpathian Basin, *Elektronische Publikationen des Deutschen Archäologischen Instituts* 1. Rahden. 2011, f. 109-122.

Sari Deniz, Şemsettin Akyol, The Early Neolithic pottery of Keçiçayiri and its place in the North-western Anatolian Neolithisation proces, *Documenta Praehistorica*, 46, University of Ljubljana press Journals, 2019, 138-156.

Susan Allen, *Second Impressions: Expanding the Range of Cereals from Early Neolithic Franchthi Cave, Greece*, *Ethnobiology Letters* 9, no. 2, University of Boston, 2018, f. 189-196.

Tanya Dzhanfezova, *Organic temper and the Early Neolithic pottery production: interpretational challenges*, *Acta Archaeologica* 91, no. 2. Kopenhagë, 2020, f. 61-87.

## THE INFLUENCE OF WESTERN ANATOLIA ON THE CREATION OF STARÇEVO'S CULTURE EXPLAINED BY EXAMPLES OF THE KOSOVA'S VARIANT

### Summary

This initiative, which serves to shed light on a phenomenon such as the influence of western Anatolia on the creation of Starcevo culture, is only a very small step dealing with this issue, that experts from the occident have not worked hard enough on it, not even local experts of these cultural areas, even less the experts of other Balkan cultures who were affected by the same phenomenon, and not at all the specialists from Kosova. To explain this phenomenon, the first focus will be directed toward the movement of the population and its very reasons, that went from western Anatolia, which encompasses in itself three cultural groups, the north-western around the Fikirtepe site, the central western around Izmir and the south-western or as it is called otherwise the Lake District or the culture of Hacilar, to the Starčevo zone, passing through the cultures of the Balkan that borders them or are closest to, and based on this, the comparison will be made with archaeological findings such as architecture, pottery and tools, between these two and the eastern Balkan Group, and the Aegean Group with Thessalian and Macedonian culture.

**Keywords:** *Starčevo, Western Anatolia, influence, Movement of Population, Balkan.*

